

BETEJA PËR NJË KREVAT!

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2025

BETEJA PËR
NJË KREVAT!

QENDRESA
QYTETARE



NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING THE POLICE & UPHOLDING THE PEOPLE



AUTOR
MATEO YSKOLLARI

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE.....	3
2. METODOLOGJIA	4
3. KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM HISTORIK MBI REZIDENCAT STUDENTORE UNIVERSITARE.....	6
3.1. Rezidenca Studentore nr.1	6
3.2. Rezidenca Studentore nr.2.....	7
4. PROCESI I APLIKIMIT DHE TARIFAT E AKOMODIMIT NË REZIDENCAT STUDENTORE	8
5. RIKONSTUKSIONI I GODINAVE NË REZIDENCAT STUDENTORE DHE NDIKIMI TE NUMRI I STUDENTËVE TË REGJISTRUAR	11
6. KAPACITETI DHE REGJISTRIMET NË RSU NR.1 DHE RSU NR.2	13
6.1 A zgjedhin studentët të banojnë në Rezidencat Studentore?!	15
GJETJET KRYESORE	19
REKOMANDIME	20

1. HYRJE

Referuar të dhënave zyrtare¹, në sistemin universitar shqiptar ndjekin studimet gjithsej 122,613 studentë. Prej tyre, 70.9% janë të regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë, ndërsa 29.1% ndjekin studimet në institucionet private. Të dhënat e INSTAT² për vitin akademik 2024-2025 tregojnë gjithashtu se 59% e studentëve të universiteteve publike studiojnë në kryeqytet.

Sot studentët shqiptarë përballen me një barrë gjithnjë e më të rënduar financiare, jo vetëm për shkak të kostove të akomodimit, por edhe të shpenzimeve të përditshme të jetesës. Në pesë vitet e fundit, niveli i përgjithshëm i çmimeve³ është rritur me 17.4%, duke ndikuar drejtpërdrejt në buxhetin e tyre dhe duke e bërë më të vështirë mbulimin e nevojave bazë. Kjo rritje reflektohet në qiratë, ushqim, transport dhe shërbime të tjera esenciale, duke e kthyer jetën studentore në një sfidë të vazhdueshme për shumë të rinj dhe familjet e tyre.

Sipas të dhënave të fundit të raportura, në vitin 2023, të ardhurat mesatare mujore të disponueshme për frymë, të ekuivalentuara në lekë janë 42,209 lekë⁴. Për një familje me të ardhura në këtë nivel, mbulimi i kostove të studimit dhe jetesës së një studenti në kryeqytet paraqet një sfidë të madhe. Kjo sepse shumica e studentëve nuk janë të përfshirë në tregun e punës, ndërsa ata që arrijnë të punojnë, zakonisht janë të angazhuar me orar të pjesshëm për shkak të studimeve dhe përfitojnë të ardhura minimale, të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet reale të jetesës.

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen çdo student që nis studimet në Tiranë është strehimi. Për studentët që vijnë nga qytetet e tjera, alternativat janë të kufizuara. Ato ose do të banojnë me miq apo të afërm në apartamente me qira, ose të regjistrohen në rezidencat studentore universitare.

Nëse i referohemi të dhënave të INSTAT për vitin 2025⁵, çmimet e grupit "Qira" janë rritur me 0,18 pikë përqindje, ndërsa gjatë pesë viteve të fundit janë shënuar rritje me 10.5%. Ky trend e ka bërë tregun e banesave gjithnjë e më pak të përballueshëm për studentët. Për shkak të lokalizimit të universiteteve publike në qendrat kryesore të kryeqytetit, çmimet e banesave me qira variojnë mesatarisht nga

¹ <https://www.instat.gov.al/media/mxfk42qo/statistikat-e-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2024-2025.pdf>

² <https://www.instat.gov.al/media/5xifzrav/tab4.xlsx>

³ <https://www.instat.gov.al/media/yhwf4pvd/tab-5.xlsx>

⁴ <https://www.instat.gov.al/media/kclctmxg/matja-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jeteses-2023.pdf>

⁵ https://www.instat.gov.al/media/b1rdught/ick_ianar_2025.pdf

45,000-60,000 lekë në muaj, shifra këto tepër të larta për buxhetin e një studenti. Për pasojë, bëhet e domosdoshme që rezidencave studentore t'u kushtohet një vëmendje e posaçme si alternativa e vetme e qëndrueshme dhe e përballueshme për strehimin e tyre.

Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Tiranë, në vitin akademik 2024-2025, numri total i studentëve të akomoduar pranë rezidencave studentore universitare nr.1 dhe nr.2, në total është 4,685 studentë nga 7,593 studentë në kapacitet për t'u akomoduar, duke lënë rreth 40% të shtretërve bosh. Në rezidencat studentore banojnë rreth 9% apo 1 në 11 studentë nga totali i studentëve në universitetet publike në Tiranë.

Ky raport monitorimi ka për qëllim të analizojë situatën aktuale të rezidencave studentore në Shqipëri, me fokus të veçantë në Tiranë, duke shqyrtuar kapacitetet ekzistuese, normat e shfrytëzimit, kushtet e akomodimit dhe përshtatjen e tyre me nevojat reale të studentëve. Raporti synon të evidentojë problematikat strukturore, ekonomike dhe sociale që lidhen me këto rezidenca, duke adresuar faktorët që ndikojnë në zgjedhjen ose refuzimin e tyre nga studentët. Gjithashtu, do të trajtohet dimensionin i sigurisë dhe cilësisë së jetesës në këto hapësira, në raport me standardet bashkëkohore të strehimit studentor në nivel kombëtar dhe rajonal. Në fund, analiza do të shërbejë si bazë për të propozuar rekomandime konkrete për përmirësimin e infrastrukturës, menaxhimit dhe politikave të strehimit studentor, në funksion të përmirësimit të përvojës akademike dhe sociale të studentëve në Shqipëri.

2. METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në një qasje kërkimore me natyrë cilësore dhe sasiore, me qëllim analizimin e situatës aktuale të rezidencave studentore universitare në Shqipëri, duke u fokusuar veçanërisht tek ato në Tiranë. Kjo metodologji është ndërtuar për të siguruar një analizë të thelluar, të besueshme dhe objektive, që jo vetëm pasqyron situatën aktuale të rezidencave studentore, por edhe orienton drejt rekomandimeve praktike për përmirësimin e politikave publike dhe menaxhimit të tyre.

1. Qasja kërkimore

Metodologjia e këtij punimi është ndërtuar mbi dy shtylla kryesore: analizën dokumentare dhe krahasimin statistikor. Fillimisht, janë shqyrtuar burime zyrtare si publikimet e INSTAT, raportet e Bashkisë Tiranë, të dhëna të siguruar nga Rezidencat Studentore Universitare (RSU nr.1 dhe nr.2), si dhe studime të mëparshme që trajtojnë problematikën e strehimit studentor. Në vijim, për të nxjerrë një

panoramë më të qartë mbi zhvillimet në kohë, të dhënat statistikore të marra nga Bashkia Tiranë lidhur me RSU⁶ nr.1 dhe RSU nr. 2, të vitit akademik 2024–2025 janë krahasuar me ato të viteve të mëparshme, duke u fokusuar tek trendet e akomodimit, normat e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe ndryshimet strukturore në menaxhimin e rezidencave studentore.

2. Teknikat e mbledhjes së të dhënave

- **Të dhëna sekondare:** U siguruan nga raportet institucionale, dokumentet zyrtare dhe publikimet dhe raportet mediatike mbi kushtet e jetesës në rezidencat studentore.
- **Vëzhgim i drejtpërdrejtë:** Janë marrë në konsideratë përshkrime të kushteve aktuale përmes vizitave në terren dhe raportimeve të studentëve të cilët aktualisht jetojnë në Rezidencat Studentore.

3. Analiza e të dhënave

Në kuadër të këtij punimi, të dhënat janë ndarë dhe përpunuar në dy dimensione kryesore: sasiore dhe cilësore. Të dhënat sasiore, të cilat përfshijnë numrin e studentëve të akomoduar, kapacitetet e rezidencave, tarifat e akomodimit dhe ndryshimet e çmimeve të qirave në tregun privat, u analizuan me qëllim nxjerrjen e indikatorëve të qartë krahasues që ndihmojnë në evidentimin e trendeve dhe problematikave kryesore. Ndërkohë, të dhënat cilësore, të mbledhura përmes perceptimeve të studentëve, përshkrimeve mbi vështirësitë praktike dhe problematikave të infrastrukturës, u sistemuan sipas temave kryesore që lidhen me cilësinë e jetesës, sigurinë, përballueshmërinë dhe aksesueshmërinë, duke krijuar një pasqyrë më të plotë mbi realitetin e përditshëm të jetesës në rezidencat studentore.

⁶ Rezidenca Studentore Universitare

3. KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM HISTORIK MBI REZIDENCAT STUDENTORE UNIVERSITARE

Me themelimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës në vitin 1957, nisi edhe procesi i ngritjes së asaj që më vonë do të marrë përmasat e “Qytetit Studenti”. Fillimisht u ndërtuan disa godina bazë për akomodimin e studentëve, të shoqëruara me shërbime thelbësore si mensa, ambulanca universitare dhe biblioteka, të cilat kishin për qëllim të mbështesnin të rinjtë që vinin nga rrethet për të studiuar në kryeqytet.

Gjatë dekadës së parë, infrastruktura e “Qytetit Studenti” u sistemua dhe u gjelbërua, ndërsa ndriçimi elektrik dhe pajisjet e tjera u përmirësuan për të krijuar një mjedis më të përshtatshëm për jetesë. Në vitet '60- '70 u ndje nevoja për zgjerim, për t'iu përgjigjur rritjes së numrit të studentëve.

Në vitin 1968 filloi formalisht ndërtimi i kampusit “Qytet Studenti” në juglindje të Tiranës, i konceptuar si një zonë e dedikuar për jetesë akademike, e ndërtuar mbi parimin e përqëndrimit të universiteteve dhe rezidencave në një zonë të vetme.

Në dhjetor 1990, nga vetë rëndësia që kishte, ky kompleks studentor u shndërrua në epiqendrën e protestave pro-demokraci, duke simbolizuar përplasjen me sistemin komunist dhe aspiratën për ndryshim. Ishte pikërisht nevoja për kushte më të mira në rezidencat studentore ajo që shërbeu si pikënisje e protestave të studentëve të Dhjetorit '90.

3.1. Rezidenca Studentore nr.1

Qyteti Studenti sot është i lokalizuar në Njësinë Administrative nr.2 në Bashkinë e Tiranës në një sipërfaqe të konsiderueshme prej rreth 25 hektarësh prej të cilave 26.8% janë privatizuar dhe janë të banushme nga qytetarë duke e kthyer “Qytetin Studenti” në një lagje akomoduese të Tiranës. Sot ky territor mban emrin Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, e cila është struktura me kapacitetin më të madh akomodues të studentëve në vendin tonë.






3.2. Rezidenca Studentore nr.2

Kjo rezidencë studentore deri në vitin 2015 ka qenë 100% në zotërimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, nën emrin "Trajnimi Studentor nr.2".⁷ Më datë 20/07/2015, me anë të Urdhërit Nr.68/14 Akti, datë 8.7.2015, "Për Vënien e Sekuestros Konservative", lëshuar nga Shoqëria Përmbarimore "BESNIK BAJRAKTARI", drejtuar QKR, u urdhërua vendosja e masës sekuestro konservative mbi të gjitha aksionet e regjistruara në emër të debitorit Shoqëria "Trajnimi Studenti Nr.2".

Në datë 04.06.2018, në bazë të Vendimit të Asamblesë Nr.06 datë 30.05.2018, është miratuar ndryshimi i emrit tregtar nga "NDRM.TRAJTIMIT STUDENTËVE NR.2" u bë "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.2"⁸

Sot, Rezidenca Studentore Universitare Nr.2, ka 4 godina akomoduese, e krijuar shumë më vonë se "Qyteti Studenti", nisur nga nevoja akomoduese e studentëve është një shoqëri aksionere nën zotërimin 100% të Bashkisë Tiranë që siguron akomodimin e studentëve nga e gjithë Shqipëria. Kryesisht, në mjediset e saj, janë sistemuar studentë që studiojnë në profilet inxhinieri, mjekësi, sporte, shkenca sociale, shkencat e natyrës etj.



**BETEJA PËR
NJË KREVAT!**


⁷ <https://opencorporates.al/sq/nipi/k517300221>

⁸ <https://opencorporates.al/sq/nipi/k517300221>, kategoria "Emri i Tregëtarit"

4. PROCESI I APLIKIMIT DHE TARIFAT E AKOMODIMIT NË REZIDENCAT STUDENTORE

Aktualisht, çdo student mund të aplikojë për t'u regjistruar në Rezidencat Studentore në çdo kohë (nëse ka dhoma të lira) në secilën godinë pranë aplikacionit "Tirana Ime". Procedura tashmë e digjitalizuar ka lehtësuar sadopak radhët e gjata të pritjes në administratë, por ende ka problematika thelbësore të cilat do ti analizojmë në vijim.

Studentët pasi kanë shkarkuar aplikacionin "Tirana ime", kanë një hapësirë të dedikuar të regjistrimit në konvikte, me anë të së cilës mund të rezervojnë dhomën e konviktit në rezidencën studentore të cilën kanë përzgjedhur.



Për të parë rezidencat dhe dhomat e lira studenti mjafton të plotësojë vetëm fushën e gjinisë në mënyrë që aplikacioni të shfaqë vetëm rezidencat të cilat kanë kapacitet për gjininë përkatëse.

**BETEJA PËR
NJË KREVAT!**

Pasi studenti ka plotësuar të gjitha të dhënat dhe ka zgjedhur dhomën, aplikacioni i gjeneron atij kapacitetin e dhomës dhe shtratin e lirë. Shoqëruar me këto të fundit studenti njihet edhe me pagesën mujore të konviktit ku po regjistrohet.

Pasi janë plotësuar të gjitha këto hapa, studenti ka 72 orë të kryejë pranë bankës “Banka Kombëtare Tregëtare” (BKT), pagesën për dhomën e rezervuar dhe të dorëzojë mandatin e pagesës pranë administratës së rezidencës studentore përkatëse në mënyrë që të përmbyllë rezervimin.

Në të kundërt nëse studenti nuk kryen pagesën, dhoma e cila ai kishte rezervuar shpallet automatikisht e lirë në aplikacionin “Tirana Ime” në mënyrë që studentët e tjerë të interesuar të kenë mundësinë që ta rezervojnë përsëri.

Ndonëse procedura është tepër e thjeshtë në dukje, studentët vijnë të përballen me problematika të shumta sa i përket detyrimeve në pagesa të cilat tejkalojnë periudhat e parashikuara kohë më parë.

**BETEJA PËR
NJË KREVAT!**

Nëse i referohemi tarifave të bëra publike nga vetë Administrata e Rezidencave Studentore, ato janë si vijon:

Rezidencat	Tarifa Mujore
Rezidencat nr. 1 dhe nr. 8 (Universiteti Bujqësor Tiranë) dhe Rezidencat nr. 11, 12, 13, 15, 18, 20, 21, 22, 23 (Qyteti Studenti)	5,500 lekë
Rezidenca nr. 6 (Qyteti Studenti)	5,000 lekë.
Rezidencat nr 2, 5, 7, 8, 9, 10, 24, 25, 26, 27, 28, 29 (Qyteti Studenti)	4,500 lekë
Rezidencat nr. 4, 16, 17 (Qyteti Studenti)	6,500 lekë
Rezidencën nr. 1 (Qyteti Studenti)	10,000 lekë

Tarifat e rezidencave studentore ndryshojnë në varësi të periudhës së ndërtimit ose rikonstruksionit, si edhe të kushteve që ofrohen. Godinat më të vjetra, të cilat shpesh ofrojnë vetëm kushte bazike dhe në disa raste aspak të përshtatshme aplikojnë tarifën më të ulët. Në një nivel më të lartë qëndrojnë rezidencat e rikonstruktura vitet e fundit, të cilat ofrojnë kushte disi më të mira dhe kanë tarifa më të rritura. Ndërkohë, tarifën më të lartë i përket godinave të reja, të sapondërtuara, që ofrojnë kushte bashkëkohore dhe standarde më të larta jetese.

Megjithatë, këto godina të reja janë ato që zakonisht përdoren si "vitrinë" kur prezantohen rezidencat studentore, ndërkohë që realiteti i shumicës së godinave mbetet i ndryshëm dhe shpesh shumë larg standardeve të promovuara.

Deri në fundin e vitit akademik 2024- 2025, studentit i duhet të paguante 6- 10 muaj tarifë regjistrimi, ndërkohë me kalimin e kohës, rregullimin dhe hapjen e godinave të tjera me kushte më të mira dhe duke ditur se tashmë kërkesa për t'ju afruar asaj që dikur quhej "Qyteti Studenti" do të rritej, administrata ka detyruar studentët që të kryejnë pagesat për një vit të plotë.

Sa i përket këtij informacioni të ardhur dhe konfirmuar nga vetë studentët është e dukshme që këta të fundit drejtohen drejt konvikteve pasi jetesa jashtë tyre është tepër e shtrenjtë për t'u përballuar si nga vetë ata, por edhe nga familjet e tyre, e nisur nga ky fakt administrata nuk duhet të kalojë në abuzime me "paratë e studentëve".

5. RIKONSTUKSIONI I GODINAVE NË REZIDENCAT STUDENTORE DHE NDIKIMI TE NUMRI I STUDENTËVE TË REGJISTRUAR

Deri në vitin 2020, një pjesë e konsiderueshme e godinave ku akomodohehin studentët, përfshirë edhe një pjesë të madhe të Rezidencës Studentore Nr.1 në "Qytetin Studenti" ishin të amortizuara dhe në kushte jo të përshtatshme, madje disa prej tyre gati të rrënuara. Kjo situatë e bënte jetesën e studentëve në këto ambiente jashtë çdo standardi të pranueshëm dhe shpesh të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre.

Gjendja u rëndua sidomos pas tërmetit të vitit 2019, i cili shkaktoi dëme të konsiderueshme në disa prej godinave më të vjetra. Për shkak të mungesës së mirëmbajtjes dhe vëmendjes institucionale, një pjesë e tyre dolën jashtë funksionit, ndërsa disa u mbyllën plotësisht.

Sipas një raporti të publikuar nga Faktoje.al, Qeveria Shqiptare, me VKM nr. 1134, datë 24.12.2020, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit apo rikonstruksionit të objekteve arsimore, në bashkinë Tiranë dhe caktimin e bashkisë Tiranë si njësi zbatuese", i akordoi Bashkisë Tiranë një fond prej rreth 1.61 miliardë lekësh (afërsisht 13.2 milionë euro). Ky fond u dedikua për rindërtimin e disa rezidencave studentore (konvikteve) si edhe të një shkolle.


Në këtë vendim janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar objektet arsimore që përfitojnë nga financimi. Ato i gjeni të pasqyruara në tabelën më poshtë:

OBJEKTI	VLERA VKM
RSU NR.1 (NR. 15)	313,436,038
RSU NR.1 (NR. 16)	311,425,288
RSU NR.1 (NR. 18)	311,425,288
RSU NR.1 (NR 20-21 DHE 22-23)	456,772,100

Rikonstruksioni i këtyre godinave ka kërkuar shpenzime të konsiderueshme dhe, sipas Faktoje.al, procesi ka tejkaluar afatet e përcaktuara për përfundimin e punimeve. Megjithatë, sot është e dukshme se kushtet e ofruara për studentët e akomoduar në to janë përmirësuar ndjeshëm.

Pyetja që lind është: sa ka ndikuar realisht ky ndryshim në numrin e studentëve që zgjedhin të banojnë në këto rezidenca? Për ta vlerësuar këtë, në vijim do të analizojmë ndryshimet në numrin e studentëve të akomoduar pranë Rezidencës Studentore Universitare nr.1, duke

krahasuar periudhën para dhe pas rikonstruksionit të godinave, konkretisht në tre vitet e fundit.



Në vetëm tre vite numri i studentëve të akomoduar pranë Rezidencës Studentore Nr.1 ka rënë me 838 studentë edhe pse në këto vite kemi hapjen e godinave të reja si edhe rikonstruksionin e një pjesë të godinave të dëmtuara.

Nëse shohim vitin 2024 kemi një rritje me 121 studentë në këtë Rezidencë krahasuar me vitin 2023, nga këto të dhëna kuptojmë se me ndryshimet e mëdhaja të kushteve në vitin 2023 në Qytetin Studenti kemi vetëm një lëvizje të brendshme të studentëve, ku ata që ndodheshin aktualisht në godinat e vjetëruara lëvizën drejt atyre me kushte më të mira, duke lënë godinat e vjetëruara pothuajse pa studentë, nga ana tjetër kjo lëvizje e brendshme e studentëve ka penguar regjistrimin e studentëve të rinj pranë kësaj rezidence për shkak të kushteve në godinat e mbetura të lira të saj.

Tabela 1 Numri i studenteve të regjistruar në rezidencat e parikonstruktura para dhe pas rikonstruksioneve në Qytetin Studenti

RSU Nr.1	Kapaciteti	Regjistrime 2023	Regjistrime 2025	Ndryshimi %
Rezidenca nr.2	118	102	35	↓ 66%
Rezidenca nr.9	242	227	92	↓ 59%
Rezidenca nr.10	250	206	99	↓ 52%
Totali:	610	535	226	↓ 58%

Të dhënat janë marrë nga Bashkia Tirane dhe përpunuar nga autori

Nëse shohim numrin aktual të studentëve që banojnë në disa prej rezidencave të parikonstruktura do të vëmë re se ai është shumë herë më i ulët sesa ka qenë para nisjes së rikonstruktimit të godinave të tjera apo hapjes së godinave të reja në Qytetin Studenti. Kjo e fundit na fakton se studentët i kanë braktisur këto banesa nga kushtet e pajetueshme në to dhe janë drejtuar drejt rezidencave të reja, duke i lënë këto të fundit aktualisht të pabanueshme dhe me një trend drejt mbylljes.

Nga ana tjetër godinat e reja, ato të sapondërtuara kanë një kërkesë në rritje dhe rezultojnë të në kapacitetet maksimale, duke mos u bërë të dukshme më në aplikacionin "Tirana Ime", në mënyrë që të mund të aksesohen edhe nga studentë të tjerë.

Aktualisht në 3 rezidencat e mësipërme banojnë 226 studentë, 58% më pak se dy vite më parë, duke lënë kështu 384 shtretër të pa shfrytëzueshëm nga të tjerët aktualisht.

Janë pikërisht këta 309 studentë që, për shkak të kushteve jo të përshtatshme në rezidencat studentore dhe mungesës së shtretërve të lirë në godinat e tjera, detyrohen të zgjedhin banesat me qira. Ky opsion, ndonëse i vetmi i mbetur, i ekspozon ata ndaj kostove shumë më të larta.

6. KAPACITETI DHE REGJISTRIMET NË RSU NR.1 DHE RSU NR.2

Rezidenca Studentore	Numri i Rezidencave	Kapaciteti (shtretër)
RSU Nr.1	34	5736
RSU Nr.2	8	1857

Nga të dhënat e marra nga Bashkia Tiranë Rezidenca Studentore Nr. 1 ofron për studentët 5,736 shtretër akomodues, ndërsa Rezidenca Studentore Nr.2, 1857 shtretër akomodues. Në total të dyja Rezidencat Studentore mbulojnë akomodimin e 7,593 studentëve.

Në universitetet e Tiranës aktualisht vazhdojnë studimet e tyre 51,036 studentë. Nga këta të fundit vetëm 14.9% e tyre mund të akomodohen pranë këtyre rezidencave studentore, duke detyruar thuajse 85.1% t'i drejtohen tregut të banesave me qira.

Në Rezidencën Studentore Universitare Nr.1 vetëm 28 rezidenca nga 34 në total janë të banueshme nga studentët, ndërkohë arsyeja se pse 6 rezidenca nuk janë në funksion nuk bëhet e ditur nga asnjë organ kompetent.

Në 36 rezidencat e banueshme aktualisht banojnë 4,685 studentë dhe janë 2,098 shtretër të lirë, të ndarë në rezidenca si më poshtë:

Rezidenca	Kapaciteti aktual	Korrik 2025
2	118	35
3	0	0
4	123	122
5	172	63
6	170	98
7	214	0
8	210	0
9	242	92
10	250	99
11	206	202
12	249	245
14	123	0
15	304	284
16	178	176
17	180	180
18	304	104
20	136	136
21	154	153
22	136	107
23	154	118
24	233	88
25	226	70
26	221	58
27	209	80
28	231	52
29	229	56
Totali	4972	2618

Rezidenca	Kapaciteti aktual	Korrik 2025
Rez. nr.1	102	42
Rez. nr.13	132	44
	234	86

Në tre prej këtyre rezidencave nuk banon asnjë student. Aktualisht rezulton se rezidenca nr. 14, nr.7, nr.8 të cilat së bashku kanë një kapacitet prej 547 shtretërsh, janë aktualisht të pabanueshme nga studentët.


Rezidenca UBT	Kapaciteti aktual	Korrik 2025
Rez. nr.1	252	60
Rez. nr.8	278	64
	530	124

**BETEJA PËR
NJË KREVAT!**

Nëse shohim statistikën krahasimore të kapacitetit të shtretërve me një vit më parë:

Viti 2023-2024		Viti 2024-2025	
Rezidenca Studentore	Kapaciteti	Rezidenca Studentore	Kapaciteti
RSU Nr.1	5136	RSU Nr.1	5736
RSU Nr.2	1526	RSU Nr.2	1857

vëmë re se aktualisht në total të dyja rezidencat kanë 931 shtretër më shumë krahasuar me vitin 2023-2024, por akomodojnë 979 studentë më pak krahasuar me po të njëjtin vit.



Grafiku më sipër paraqet totalin në të dyja këto rezidenca ku nga analiza sasiore e të dhënave, vihet re se në vitin akademik 2024 kapaciteti i rezidencave arrin në 6,662 shtretër, duke akomoduar 5,576 studentë, ç'ka tregon një diferencë prej 1,086 shtretër të pashfrytëzuar, ndërsa në vitin 2025 kapaciteti shënon rritje të ndjeshme në 7,593 shtretër, por numri i studentëve të akomoduar bie në 4,597, duke krijuar një braktisje edhe më të madhe prej 2,996 shtretër bosh.

6.1 A zgjedhin studentët të banojnë në Rezidencat Studentore?!

Nëse i referohemi të dhënave statistikore të paraqitura deri më tani dhe informacionit mbi tarifat, kushtet e akomodimit dhe trendet e regjistrimit, do të kuptojmë se pyetja që shpesh bëhet sot "A zgjedhin studentët të banojnë në rezidenca studentore?" nuk ka një përgjigje të thjeshtë "po" ose "jo", por kërkon një analizë të ndërlikuar sasiore dhe cilësore.

Në planin sasior, shohim se kapaciteti i shtretërve është rritur ndjeshëm, megjithatë, numri i studentëve të akomoduar ka pësuar rënie drastike, nga 5,576 në 4,597, duke prodhuar një braktisje reale dhe duke lënë

2,996 shtretër bosh. Kjo mospërputhje e fortë midis kapacitetit dhe shfrytëzimit evidenton qartë se studentët nuk po i mbushin plotësisht rezidencat, pavarësisht se janë më të shumta dhe më të reja.

Në planin cilësor, arsyeja kryesore lidhet me diferencat e kushteve dhe politikave tarifore. Tarifat variojnë nga 4,500 lekë në godinat e vjetra deri në 10,000 lekë në godinat e reja me kushte bashkëkohore, pra, ndërsa një pjesë e studentëve zgjedh godinat e reja për cilësinë, të tjerë shmangin rezidencat e amortizuara që janë praktikisht të pabanueshme.

Në disa raste, studentët braktisin rezidencat e vjetra dhe zhvendosen në godinat e reja, duke krijuar një "migrim të brendshëm" që rrit boshllëkun e shtretërve në ndërtesat e amortizuara (p.sh., në RSU nr. 2, 9 dhe 10 numri i banorëve është ulur nga 535 në 226 në vetëm dy vite).

Një faktor tjetër cilësor është politika e pagesës së plotë për një vit akademik, e cila është bërë e detyrueshme nga administrata, duke e bërë më të vështirë financiarisht për studentët që më parë paguanin vetëm 6-10 muaj, kjo e shton barrën ekonomike mbi familjet, në një kohë kur jetesa me qira në tregun privat është edhe më e shtrenjtë.

Për pasojë, studentët ndodhen përballë një dileme të dyfishtë, të zgjedhin jetesën në konvikte të reja, por më të shtrenjta, ose të shmangin konviktet e vjetra për shkak të kushteve minimale, duke iu drejtuar apartamenteve me qira që shpesh bëhen të papërballueshme.

Nëse vërejmë statistikën do të kuptojmë se zgjedhja e studentëve për të banuar në rezidenca studentore nuk është absolute, por e kushtëzuar nga raporti midis cilësisë së kushteve, tarifave të akomodimit dhe alternativave të tjera të jetesës, (megjithëse shumica e tyre mbeten të varur nga konviktet për shkak të kostos së lartë të tregut të banesave), të dhënat tregojnë qartë një rënie të interesit për rezidencat që nuk garantojnë kushte dinjitoze, duke i treguar institucioneve të veprojnë sa më shpejt edhe me godinat e tjera dhe duke prodhuar një fenomen të dyfishtë, mbushje të plotë të godinave të reja dhe boshatisje progresive të atyre të amortizuara.

Problemi nuk mbetet vetëm në këtë pikëpamje, por nga monitorimi i bërë rezulton se problemi më i madh lidhet me mbajtjen "peng" të dhomave në godina specifike nga administrata, duke krijuar një realitet fiktiv në aplikacionin "Tirana Ime".

Rezidenca	Kapaciteti	2025
2	118	35
4	123	122
5	172	63
6	170	98
9	242	92
10	250	99
11	206	202
12	249	245
15	304	284
16	178	176
18	304	104
22	136	107
23	154	118
24	233	88
25	226	70
26	221	58
27	209	80
28	231	52
29	229	56
Totali	3955	2149

Më sipër kemi paraqitur rezidencat me dhoma të lira akomoduese pranë RSU NR.1. Po i referohemi në analizë vetëm njerës prej rezidencave, asaj nr.2. Nga të dhënat shohim se në rezidencën nr.2 (rezidencë e dedikuar për meshkuj), aktualisht kemi 83 shtretër të lirë.

Nese shohim në aplikacion dhomat e lira të Rezidencës nr.2, do të vëmë re se rezultojnë vetëm 40 shtretër të lirë, pra gati 43 shtretër më pak se realiteti statistikor i regjistrimeve në arkivin e Bashkisë Tiranë.

Nëse shkojmë më tej, disa dhoma të tjera që sipas statistikave të Bashkisë Tiranë (rezidenca nr.6, nr.4, nr.16, për djem) figurojnë bosh, nuk shfaqen të lira në aplikacionin zyrtar, duke ngritur dyshime mbi përdorimin e qëllimshëm të kësaj mospërputhjeje për interesa klienteliste.

Godinat e lira për meshkuj, foto e kapur në datën 13 gusht 2025, rezulton se vetëm rez.nr.2 ka dhoma të lira.

Kjo situatë nxit një praktikë të "qokave", ku aksesimi i një dhome të

**BETEJA PËR
NJË KRE VAT!**

mirë apo në një godinë të re nuk varet më nga transparenca e sistemit digjital, por nga njohjet personale, lidhjet familjare, apo marrëdhëniet joformale me stafin administrativ.

Në aspektin social, kjo situatë nxjerr në dukje një perceptim të fortë të mungesës së barazisë sociale, pasi studentët pa rrjete mbështetëse shoqërore mbeten të kufizuar në mundësinë e tyre për të siguruar akomodim të denjë. Ndërkohë, ky fenomen përkeqëson edhe më shumë raportin midis kapacitetit dhe shfrytëzimit, duke lënë qindra shtretër bosh në letër, por të padisponueshëm realisht për ata që kanë më shumë nevojë.

Nëse ky trend vazhdon, krijohet një “rezervë e fshehur” e dhomave, e cila nuk shërben për të balancuar kërkesë-ofertën, por për të forcuar praktika arbitrare dhe për të kthyer të drejtën e studentëve në një privilegj të kufizuar. Kjo jo vetëm që dëmton besueshmërinë e administratës dhe transparencën e procesit, por edhe i shton presionin financiar studentëve, të cilët, të përjashtuar nga ky sistem i deformuar, detyrohen të zgjedhin alternativa më të kushtueshme jashtë rezidencave.

Gjithashtu mbetet e pakuptueshme fakti se pse për disa disa rezidenca (nr.1, nr.13, nr.18) regjistrimi bëhet vetëm fizikisht dhe jo nëpërmjet aplikacionit.

Nese doni te godinat mikse 1-13
dhe 18 regjistrimet behen vetem te
drejtoria.



Te gjitha godinat qe nuk ju dalin do
te thote qe nuk kane hapsira te lira

Mesazh i siguruar nga studentet e RSU nr.1

Në terma akademike, kjo përfaqëson një formë të qartë të “kapjes institucionale” ku resurset publike, në vend që të menaxhohen për të përmbushur interesin kolektiv, transformohen në instrumente të përfitimit klientelist dhe selektiv.

GJETJET KRYESORE

1. Rezidenca Studentore Nr. 1 ofron për studentët 5,736 shtretër akomodues, ndërsa Rezidenca Studentore Nr.2, 1,857 shtretër akomodues. Në total të dyja rezidencat studentore mbulojnë akomodimin e 7,593 studentëve.
2. Vetëm 14.9% e studentëve që studiojnë në universitetet publike të Tiranës mund të akomodohen pranë këtyre rezidencave studentore, duke detyruar thuajse 85.1% t'i drejtohen tregut të banesave me qira.
3. 36 rezidenca janë aktualisht të banueshme nga 40 në total, kjo e pasqaruar nga asnjë institucion kompetent. Në rezidencat studentore banojnë aktualisht 4,685 studentë dhe janë gati 2,908 shtretër të lirë.
4. Në vetëm tre vite numri i studentëve të akomoduar pranë Rezidencës Studentore Nr.1 ka rënë me 838 studentë edhe pse në këto vite kemi hapjen e godinave të reja si edhe rikonstruktimin e një pjesë të godinave të dëmtuara.
5. Deri në fundin e vitit akademik 2024- 2025, studentit i duhej të paguante 6- 10 muaj tarifë regjistrimi, ndërkaq me kalimin e kohës, rregullimin dhe hapjen e godinave të tjera me kushte më të mira dhe duke ditur se tashmë kërkesa për t'iu afruar asaj që dikur quhej "Qyteti Studenti" do të rritej, administrata ka detyruar studentët që të kryejnë pagesat për një vit të plotë.
6. Godinat e reja, të sponduara, rezultojnë të mbushura çdo ditë në sistem dhe nuk shfaqen më si të lira në aplikacionin "Tirana Ime", duke pamundësuar kështu aksesin e studentëve të tjerë që kërkojnë akomodim.
7. Në dy vitet e fundit në rezidencat e vjetra rezultojnë të ketë 58% më pak studentë të akomoduar, kjo për shkak të kushteve të pafavorshme.
8. Aktualisht rezultojnë se rezidenca nr.14, nr.7 dhe nr.8 të cilat së bashku kanë një kapacitet prej 547 shtretërish, janë aktualisht të pabanueshme nga studentët.
9. Bazuar në statistikën e Bashkisë Tiranë, disa rezidenca studentore për djem (nr.6, nr.4 dhe nr.16) rezultojnë bosh. Megjithatë, sipas monitorimit të Qëndresës Qytetare, ato nuk shfaqen si të lira në aplikacionin zyrtar. Kjo mospërputhje ngre dyshime se mund të jetë e qëllimshme dhe e përdorur për interesa klienteliste.

REKOMANDIME

1. Rezidencat e vjetëruara duhet ti nënshtrohen sa më shpejt rikonstruksionit në të kundërt kapacitetet ekzistuese të rezidencave studentore duhet të shfrytëzohen në mënyrë të plotë dhe të drejtë, duke u dhënë përparësi mbushjes së godinave të vjetra përmes tarifave të reduktuara ose subvencioneve, në mënyrë që ato të mos mbeten të boshatisura.
2. Duhet të rritet transparenca e aplikacionit "Tirana Ime" përgjatë procesit të rezervimit të dhomave, për këtë arsye, kërkohen auditime të pavarura mbi funksionimin e tij, publikimi periodik i të dhënave të detajuara mbi kapacitetet dhe shfrytëzimin real të dhomave, si dhe krijimi i një mekanizmi ankese për studentët, në mënyrë që të ndalen praktikat klienteliste të mbajtjes "peng" të dhomave që rezultojnë bosh në statistika, por nuk shfaqen të lira për aplikim.
3. Procesi i përzgjedhjes duhet të bazohet në një sistem transparent pikëzimi, që merr parasysh kriteret sociale dhe ekonomike të studentëve, ose në një mekanizëm përzgjedhjeje të rastësishme të dhomave, ndërsa organizatat studentore dhe aktorë të pavarur duhet të përfshihen në mbikëqyrjen e procedurës për të garantuar barazi dhe besueshmëri institucionale.
4. Administrata e rezidencave studentore duhet të ristrukturojë mënyrën e funksionimit të saj duke dhënë llogari për përdorimin e fondeve të rikonstruksionit dhe duke u vlerësuar mbi bazën e indikatorëve të qartë të performancës, si përqindja e shtretërve të shfrytëzuar dhe niveli i afrueshmërisë së studentëve drejt godinave studentore, në mënyrë që menaxhimi i konvikteve të kthehet nga një privilegj selektiv në një të drejtë të barabartë dhe të aksesueshme për të gjithë studentët.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al